

AKT THEMELIMI

I

“SHOQËRISË KONÇESIONARE SHËRBIMI DETAR” shpk

Kjo shoqëri themelohet me vullnetin e ortakëve në përputhje me ligjin nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe dispozitat e Kodit Civil në pjesën që rregullojnë personat juridikë.

Neni 1

QËLLIMI

Ortakët bien dakort të themelojnë shoqërinë koncesionare për qëllime të vecanta SPV, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për të zhvilluar veprimtari në fushën e rimorkimit detar.

Shoqëria është person juridik shqiptar, veprimtaria e të cilës rregullohet nga statuti dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 2

EMRI

Shoqëria ka emrin e saj: **“Shoqëri koncesionare Shërbimi Detar” shpk.**

Neni 3

SELIA

Selia është në Shqipëri, Durrës, L. 1, Rr “At Erazmi”, P. Fly, Nd. 54, H. 3, K. 11, Ap. 28.

Selia e shoqërisë mund të transferohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

AFATI

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me afat të pakufizuar.

Ky afat mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë: Kontratën për dhënie me Koncesion të disa Shërbimeve Detare nr. 3244 date 05.06.2017, ndryshuar me nr. 618 date 21.05.2020, lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

(i) Shërbimi i rimorkimit të anijeve gjatë operacionit të futjes e daljes nëpër porte dhe akostimit në kalatat e porteve;

(ii) Shërbimin e transportit të grupeve të praktikës së autoriteteve portuale gjatë marrjes së praktikave të lira në rada;

(iii) transportimin e equipazheve të anijeve nga rada në port dhe anasjelltas;

(iv) operacionet e ngarkim-shkarkimit të peshave të rënda në det.

Neni 6

ADMINISTRIMI

Administratori emërohet me afat **5 vjet** me të drejtë ripërtëritje.

Administrator i shoqërisë caktohet z. Bujar Hoti, dtl. 26.01.1962, mbajtës i letërnjoftimit nr. G20126137R.

Neni 7

ORTAKËT THEMELUES

Ortak themelues i shoqërisë është Shoqëria Aksionere “Anijet e Shërbimit Detar” Sh.a me Niptin J61825517G dhe seli në Shqipëri Durrës, L. 1, Rr “At Erazmi”, P. Fly, Nd. 54, H. 3, K. 11, Ap. 28.

Neni 8

KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë është në shumën 100.000 lekë, dhe është kontribut i ortakut të vetëm Shoqëria Aksionere “Anijet e Shërbimit Detar” Sha.

Kapitali fillestar dhe kontributet që përbëjnë atë akordohen në Para (lekë). Vlera e kapitalit të nënshkruar do të derdhet nga ortaku vetëm brenda afatit që do të vendoset nga Asambleja e Ortakëve për këtë qëllim.

Ortaku përballon humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së kapitalit të nënshkruar.

ORTAKU I VETEM

Shoqëria Aksionere “Anijet e Shërbimit Detar” Sha

Përfaqësuesi ligjor, Administratori

Bujar Hoti

Datë: 18/06/2020

